



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 74/1 prot.

Vlorë, më 18 . 01 .2018

**VENDIM**

**Nr. 2, datë 16.01.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 44, DATË 05.04.2017  
TË SENATIT AKADEMIK**

Në mbështetje të nenit **38** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.01.2018

**VENDOSI:**

1. Studentët e vitit të tretë të japin provime në sezonin e posaçëm të riprovimeve në janar, siç përcaktohet në paragrafin e fundit të pikës **1** në Vendimin nr. 44 të Senatit Akademik.
2. Studentët e vitit të dytë t'i nënshtrohen të njëjtit rregull si studentët e vitit të tretë, pra të japin provime në sezonin e riprovimeve në janar.
3. Kjo situatë të rishikohet dhe përditësohet me ndryshimet në Statutin dhe Rregulloren e re të UV-së.
4. Provimet të zhvillohen sipas kalendarit akademik të miratuar.
5. Vendimi regjistrohet, arkivohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen dekanët e fakulteteve, përgjegjësit e departamenteve dhe sekretarët mësimorë në fakultete.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Roland Zisi**

